per kete arsye e cileson asamblene si rregullisht te thirrur (mbledhur) ne baze te ligjit dhe ben me dije per deklarimet e te pranishmeve se ata jane mjaftueshem te informuar rreth rendit te dites se sipercituar, per te cilin kalohet menjehere ne trajtimin e tij.

Presidenti u parashtron te pranishmeve arsyet per te cilat konsiderohet si e volitshme qe te miratohet nje tekst i ri i statutit te shoqerise i perbere nga 26 (njezet e gjashte) nene, te cilet lexohen perpara asamblese.

Dr. Nicola Brangi, ne emer te Keshillit Mbikqyres, shpreh mendimin (qendrimin) ne favor te propozimit te Presidenti.

Prandaj, asambleja, ne unanimitet

**vendos**

qe te miratoje nje tekst te ri te statutit te shoqerise, te perbere nga 26 (njezet e gjashte) nene, ekzaktesisht sic eshte propozuar nga Presidenti, i cili ka formulimin (permbajtjen) e dokumentit i cili i bashkangjitet ketij akti nen shkronjen "A", duke hequr dore nga leximi.





Asambleja i jep Presidentit te drejten per te shtuar ne kete procesverbal shtesa apo ndryshime eventuale te kerkuara per qellim per te kryer rregjistrimin e vendimit ne Regjistrin Tregetar.

Prandaj, pasi nuk kishte ceshtje tjeter per te vendosur dhe pasi askush nuk e kerkoj fjalën, Presidenti e deklaroi asamblene te mbyllur ne oren 11.14.

Taksat dhe shpenzimet per kete akt jane ne ngarkim te shoqerise.

Pasi mua Noterit m'u kerkua, ia lexova kete akt te paraqiturit dhe pasi ky i fundit e miratoi dhe aprovoi, e nenshkruan me mua Noterin ne oren 11.15.

Eshte i perbere nga nje faqe e daktilografuar nga nje person i njohur dhe i besuar i imi dhe pjeserisht eshte plotesuar nga vete une Noteri prej dy faqesh e deri ketu ne faqen e trete.

Mario Granelli

Fabrizio Rossi Noter

**Rudina Mala (D. V. pi)**  
Traduttore Giurato - Sworn Translator  
Tel: +355 672624 9  
E-mail: rudidalipi@abn.com  
Ind./Adr.: Rr. "Durrës" 4.37 Kat II  
Tirana - Albania

Aneksi A

Me n. 54.070 Rep.

N. 14.853 Kol.

## STATUT

### Energy Recuperator S.P.A.

#### Emertimi, selia, objekti i shoqerise

#### Kohezgjatja

##### Neni 1 – Emertimi

Shoqeria emertohet Energy Recuperator S.P.A.

##### Neni 2 – Selia

Shoqeria e ka seline ne Komunen e Carpendolo (BS). Organi administrativ mund te themeloje, ndryshoje apo të shfuqizojë, në Itali apo jashtë vendit, filiale, degë, agjenci apo njësi vendore megjithatë te emertuara.

Adresa mund te ndryshohet me vendim te Keshillit te Administrimit me kusht qe te jete brenda te njejtës Komune.

##### Neni 3 – Adresa e kontaktit

Adresa e aksionereve, numri i telefax, adresa e postes elektronike apo adresa te tjera si edhe pika referimi tek te cilat kryhen rregullisht komunikime apo njoftime te parashikuara nga Statuti dhe gjithsesi te kryera nga Shoqeria, jane ato qe rezultojne ne librin (regjistrin) e aksionereve dhe qe duhet t'ju jene komunikuar per kete qellim te interesuarve; eshte detyre e aksionerit qe te njoftoje per ndryshimin e adreses se tij te kontaktit. Ne mungese te shenimit per adresen (te dhenat) e kontaktit ne librin e aksionereve atehere do te merret per referim adresa e rezidences ne gjendjen civile.

##### Neni 4 – Objekti

Shoqeria ka per objekt:

**Rudina Mala (Djalipi)**  
Traduttore Giurato - Sworn Translator  
Tel: +355 672624 19  
E-mail: rudidalipi@sho.com  
Ind./Adr.: Rr. "Durrës" 37 Katimi  
Tirana - Albania



- ndertimin, instalimin, shitjen dhe perfaqesimin e produkteve dhe te impianteve elektrike dhe elektronike dhe gjithsesi te sistemeve te nderlidhura, te integruara dhe te rendesishme dhe/ose te nderveprimit;

- projektimi, instalimi, mirembajtja dhe asistenca per impiantet industriale dhe civile te kondicionimit, ngrohjes, prodhimit dhe kursimit te energjise;

- tregetin ne te gjitha format e tregetit me shumice dhe me pakice si edhe blerja e perfaqesive te shoqerive italiane apo te huaja, te te gjitha produkteve, makinerive dhe pajisjeve qe kane lidhje me kete sektor;

- prodhimi i energjise, ne te gjitha format e saja, tregeti, shitja, shperndarja, transmetimit te energjise apo transmetues te energjise te cfaredo lloj natyre; menaxhimi edhe per llogari te palëve te treta ose në menaxhimin e një pale të tretë të objekteve të prodhimit apo rekuperimit të energjisë, te bashkëprodhimit, të dyja mundësuar nga burime konvencionale dhe nga burimet e ripërtëritshme dhe të përziera.

Shoqeria mund të marrë dhe të pranojë agjenci, komisione, përfaqësime, me ose pa depozite, dhe mandate, te bleje, te përdore dhe transferoje patenta dhe vepra të tjera të inteligjences (gjenit) njerëzore, të kryer kërkime të tregut dhe përpunimin e të dhënave nga llogari të vet dhe për palët e treta, të japë dhe të marrë licencat e shfrytëzimit tregëtar, si dhe përmbushjen e të gjitha operacioneve komerciale (duke përfshirë importin dhe eksportin), financiare, te pasurive te luajtshme dhe pasurive të paluajtshme, të nevojshme apo të dobishme për përmbushjen e objektit (qëllimit) te shoqerise.

Në menyre strumentale për arritjen e qëllimit të objektit te shoqerise dhe në çdo rast në rrugë jo prevalente, shoqeria mund:

- te kryeje të gjitha operacionet e pasurive te luajtshme, te pasurive të patundshme, tregëtare, industriale dhe financiare qe konsiderohen të dobishme nga Keshilli i Administrimit për arritjen dhe përmbushjen e shoqerise, duke përfshirë edhe leshimin e garancive reale dhe / ose personale të çfarëdo lloji në favor të të tretëve;

- te marrë në Itali dhe / ose jashtë vendit, ne menyre të drejtpërdrejtë dhe / ose tërthorazi, aksione dhe / ose interesa në kompani të tjera dhe / ose subjekteve tregëtare, industriale dhe / ose te shërbimeve me një qëllim të ngjashëm ose të perafert me atë të shoqerise ose qe gjithsesi konsiderohet e nevojshme ose e dobishme për arritjen e objektit te shoqerise, si dhe te menaxhoje aksionet dhe / ose të njëjtat interesa;

- te marre financimet (kredi) nga aksionerët, pa pagesë , në përputhje me rregulloret në fuqi.

Në çdo rast, shoqeria e ka në mënyrë specifike dhe te shpehur ndalimin per mblledhjen e kursimeve midis publikut si edhe ushtrimin e kredisë në përputhje me Dekretin Legjislativ 1 shtator 1993, n. 385 (i ndryshuar), aktivitetet e trustit, aktivitetet sipas Ligjit të datës 23 nëntor 1939 n. 1815 (i ndryshuar), ushtrimi profesional kundrejt publikut te shërbimeve të investimit në bazë të dekretit legjislativ te 24 shkurt 1998 n. 58 (i ndryshuar), aktivitetet e ndërmjetësimit financiar ushtrimi i të cilave u rezervohet personave të autorizuar në pajtim me nenin 106 të dekretit legjislativ 1 shtator 1993 n, 385, aktiviteti i ndërmjetësimit ose i konsulences në dhënien e kredive nga bankat apo ndërmjetësve financiarë referuar nenit 16 te ligjit 7 mars 1996 n. 108 (i

**Rudina Mala (D. L. Pi)**  
Traduttore Giurato - Sworn Translator  
Tel: +355 672624 9  
E-mail: rudidalipi@ho.com  
Ind./Adr.: Rr. "Duresit" 37 Kafi R.  
Tirana - Albania

ndryshuar) dhe çdo veprimtari tjetër që i është rezervuar me ligj për të regjistruarit në listat profesionale ose përndryshe që i nënshtrohet me ligj lejeve apo autorizimeve të veçanta.

## **Neni 5 - Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e kompanisë është e përcaktuar deri më 31 dhjetor 2050.

## **KAPITALI - AKSIONET**

### **Neni 6 - Kapitali**

6.1 Kapitali i shoqërisë është prej 430.573,00 euro (katërqind e tridhjetë mijë e pesë njëqind e shtatëdhjetë e tre presje zero zero), e ndarë në n. 430.573 (katërqind e tridhjetë mijë e pesë njëqind e shtatëdhjetë e tre) aksione të zakonshme me vlerë nominale prej 1.00 EUR (një presje zero zero) secila.

6.2 Kur kërkohet nga standardet e detyrueshme, shoqëria mund të adoptojë (zbatojë) teknikat e ndryshme të përfaqësimit, legjitimitit dhe qarkullimit të masave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

6.3 Kapitali mund të rritet, duke përfshirë kontributet në natyrë dhe gjithashtu edhe me leshimin e aksioneve të reja të kategorise së veçante, në përputhje me dispozitat ligjore në këtë drejtim, me vendim të asamblese së aksionarëve. Në rast të rritjes së kapitalit aksionar, aksionerët do të kenë të drejtën e opsionit, si edhe të drejtën e parablerjes në blerjen e aksioneve që s'jane marrë.

### **Neni 7 - Transferimi i aksioneve**

Aksionet janë lirisht të transferueshme.

### **Neni 8 – Tërheqja (Heqja dore)**

8.1 Aksionerët kanë të drejtë të heqin dorë për të gjithë ose një pjesë të veprimeve të tyre, në rastet kur e drejta është parashikuara shprehimisht në ligj. Tërheqja zbatohet gjithashtu për vendimet lidhur me:

- a) shtyrjen e afatit të kohëzgjatjes;
- b) futja, modifikimi ose heqja e kufizimeve për qarkullimin e aksioneve.

8.2 Vlera e aksioneve të çdo kategorie, për të cilën pala e tërhequr ka ushtruar të drejtën e tërheqjes është e përcaktuar sipas nenit 2437 të Kodi civil ..

8.3 Aksioneri i cili ka për qëllim të tërhiqet nga shoqëria duhet të njoftojë organin administrativ me letër rekomande (edhe PEC). Letra rekomande duhet të dërgohet brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga regjistrimi në regjistrin e shoqërive të vendimit që legjitimon tërheqjen, duke treguar gjeneralitetet e aksionarit që tërhiqet, të vendbanimit për njoftimet që lidhen me regjimin (procedurën), numrin dhe kategorinë e aksioneve për të cilën tërheqja ushtrohet.

**Rudina Mala (Dajpi)**  
Traduttore Giurato - Sworn Translator  
Tel: +355 672624 9  
E-mail: rudidalipi@shc.com  
Ind./Adr.: Rr. "Durrësit" 1.37 Kafi D.  
Tirana - Albania



8.4 Nëse fakti që legjitimon tërheqjen është i ndryshëm nga një vendim, ai mund të ushtrohet brenda tridhjetë ditëve nga marrja e tij nga aksionari tërheqës. Në këtë hipotezë, organi administrativ është i detyruar që t'u japë njoftim aksionerëve për faktet të cilat mund të sjellin ushtrimin e të drejtës së tërheqjes, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data në të cilën ai është venë vetë në dijeni.

8.5 Tërheqja konsiderohet si e ushtruar në ditën kur është marrë komunikimi nga organi administrativ. Aksionet për të cilat dhe ushtrohet e drejta e tërheqjes nuk mund të shitin dhe, nëse janë lëshuar, duhet të depozitohen pranë selisë së shoqërisë.

Për ushtrimin e të drejtës së tërheqjes duhet të bëhet shënim në librin e aksionerëve. Aplikohen, për pjesën e mbetur të dispozitave të nenit 2437 - kuater të Kodit Civil.

## Asambleja

### Neni 9 – Thirrja e Asamblese

9. Asambleja do të thirret nga Këshilli i Administrimit në rastet e parashikuara nga ligji dhe çdo herë kur organi administrativ e konsideron të nevojshme; por të paktën një herë në vit, brenda njëqind e njëzet ditëve nga mbyllja e vitit ushtrimor ose brenda njëqind e tetëdhjetë ditëve në rastin kur plotësohen kushtet e përcaktuara në nenin 2364, paragrafi i dytë i Kodit Civil.

Asambleja thirret nepermjet një njoftimi që tregon ditën, orën, vendin e takimit, të cështjeve, pikave që do të diskutohen dhe datën e thirrjes së dytë dhe të tretë të asamblese. Njoftimi i takimit publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Italisë, ose në një gazetë të përditshme kombëtare, të paktën pesëmbëdhjetë ditë para datës së caktuar për mbledhjen apo të dates që është paralajmëruar, me kusht që shoqëria nuk bën përdorimin e sipërmarrjes së tregut të kapitaleve të riskut, alternuar dhe me qëllim me letër rekomande me vërtetim pranë paraprak ose me faks ose e-mail ose me mjete të tjera të cilat garantojnë provën e marrjes në adresat, të dhenat e kontaktit apo dhe referencat e përmendura në nenin 3 më lart, që do të dërgohen së paku tetë ditë para dates së caktuar për takimin.

Asambleja mund të mbledhet në një vend tjetër përveç selisë së shoqërisë, për aq kohë sa zhvillohet në Itali.

Megjithatë, janë të vlefshme asambletë, edhe nëse nuk janë mbledhur e thirrur si më sipër, në qoftë se aty përfaqësohet i gjithë kapitali aksionar dhe merr pjesë shumica e anëtarëve të organit administrativ dhe të Këshillit Mbikqyres. Në këtë rast secili prej pjesëmarrësve mund të kundërshtojë diskutimin dhe votimin për çështjet për të cilat nuk ndihet mjaftueshëm i informuar.

Në rastin e përmendur në paragrafin e mësipërm duhet të informohet dhe njoftohet menjëherë për vendimet e marra për administratoret dhe Mbikqyresit që nuk janë të pranishëm.

9.2 Mbajtësit e aksioneve me të drejta të ndryshme nga ato të zakonshëm mbledhen në asamble të veçanta në mënyrë që të vendosin për interesat e tyre të përbashkëta dhe për vendimet e organeve të shoqërisë që ndikojnë në të drejtat e tyre. Vendimet e organeve të shoqërisë të cilat prekin të drejtat e palëve të referuara në këtë paragraf janë të pavlefshme nëqoftëse nuk miratohen nga asambleja e posaçme në bazë të nenit 2376 Kodi Civil.

**Rudina Mala (Dolipi)**  
Traduttore Giurato - Sworn Translator  
Tel: +355 672624 9  
E-mail: rudidalipi@hc.com  
Ind./Adr.: Rr. "Durrës" 377001  
Tirana - Albania

## **Neni 10 – Mbledhja me ane te videokonferences apo telekonferences**

Pjesëmarrja në asamble mund të bëhet me anë të lidhjes audio-televizive, me kusht që të jete respektuar metoda kolegjiale dhe parimet e besimit të mirë dhe te barazisë se trajtimit të të gjithë aksionarëve. Në veçanti, do të jetë e nevojshme që:

(i) t'i lejohet të Kryetarit të Asamblese, duke përfshirë edhe burimet e zyrës së tij, për të konstatuar dhe verifikuar identitetin dhe legjitimitetin e pjesëmarrësve, të drejtojnë zhvillimin e mbledhjes, te konstatoje dhe shpalle rezultatet e votimit;

(ii) t'i lejohet personit qe eshte duke mbajtur procesverbalin qe te perceptojë në mënyrë adekuate ceshtjet e asamblese qe jane objekt i Procesverbalit;

(iii) t'i lejohet pjesemarrësve qe te marrin pjese ne diskutim dhe në votimin e njëkohëshem (simultan) rreth argumentave, pikave te rendit të ditës.

Kur te verifikohen keto kushte atehere asambleja do te konsiderohet e mbajtur në vendin ku do të jetë i pranishem Presidenti i asamblese dhe personi qe mban procesverbalin.

## **Neni 11 – Thirrja e asamblese dhe vlefshmëria e vendimeve**

Asembleja, si në sesion të zakonshem ashtu edhe ne sesion te jashtëzakonshëm, quhet rregullisht e thirrur kur eshte me shumicë ligjore. Vendimet e asamblese si në sesion të zakonshem ashtu edhe ne sesion te jashtëzakonshëm, quhet rregullisht te miratuara ku jane me shumicë ligjore.

## **Neni 12 - E drejta për të marrë pjesë**

Aksioneret duhet të paraqesin aksionet e tyre për të treguar dhe provuar legjitimitetin e tyre për të marrë pjesë dhe per të votuar në asamble.

## **Neni 13 - Përfaqësimi në asamble**

Çdo aksionar qe ka të drejtë të marrë pjesë në asamble mund të përfaqësohet në format dhe Brenda percaktimeve të ligjit. Në çdo rast, e drejta e përfaqësimit nuk mund t'u jepet anëtarëve të organit administrativ ose te kontrollit ose punonjësve të shoqerise dhe filialeve të saj dhe as ketyre te fundit.

## **Neni 14 – Presidenca e asamblese. Mbajtja e procesverbaleve**

Asambleja, eshte e kryesuar nga Kryetari i Keshillit te Administrimit dhe, në rast mungese apo pengese, nga ata qe e perfaqesojne; në mungesë të tyre, nga një person tjetër i percaktuar nga asambleja.

Kryetari i asamblese, edhe me anë të personave të veçantë te ngarkuar, verifikon rregullsinë e asamblese se mbledhur, verteton identitetin dhe legjitimitetin e pjesëmarrësve, rregullon kryerjen

**Rudina Mala (D. L. P.)**  
Traduttore Giurato - Sworn Translator  
Tel: +355 672624 9  
E-mail: rudidalipi@...  
Ind./Adr.: Rr. "Durrës" 107 Kati 11  
Tirana - Albania



e puneve, duke percaktuar modalitetet për diskutim dhe votim (jo me skeda te fshehta) dhe kontrollon rezultatet e votimit.

Presidenti asistohet nga një sekretar, jo domosdoshmërisht një aksioner, i emruar nga asambleja. Kur kërkohet me ligj, ose kur asambleja e sheh të përshtatshme, funksionet e sekretarit ushtrohen nga një noter.

Procesverbali i vendimeve të asamblese është i rregulluar me ligj.

## **ADMINISTRIMI**

### **Neni 15 - Përbërja dhe Vendimet e organit administrativ**

Shoqëria administrohet nga një Keshill Administrimi i përbërë nga një minimum prej tre deri në një maksimum prej 5 (pesë) anëtarësh, madje edhe jo-aksionere, të cilët do të qëndrojnë në detyrë për një afat jo më shumë se 3 (tre) vjet ushtrimor, duke perfunduar në datën e asamblese se thirrur për të miratuar bilancin në lidhje me vitin e fundit ushtrimor të tyre të kaluar në detyrë, dhe do të kenë të drejte të rizgjidhen.

Brenda limiteve të mesiperme, në rastin e emërimit të anëtarëve të Keshillit të Administrimit, Asambleja do të përcaktojë edhe kohezgjatjen e mandatit të Administratoreve.

### **Neni 16 – Kryesia (Presidenca) dhe delegimi i të drejtave**

Keshilli i Administrimit, në qoftë se nuk është emëruar tashmë nga asambleja, emëron nga radhët e anëtarëve të saj një president (kryetar). Keshilli i Administrimit mund të delegojë brenda përcaktimeve të ligjit dhe të statutit funksionet e tij Presidentit dhe në një ose më shumë prej anëtarëve të tij duke përcaktuar edhe kompetencat e tyre.

Organet e deleguara i referojnë keshillit të administrimit dhe Keshillit Mbikqyres, të paktën çdo 6 (gjashtë) muaj, rreth performancës së përgjithshme operative dhe rreth progresit të mundshëm si edhe rreth operacioneve, transaksionet më të rëndësishme përse i përket madhësisë dhe natyrës së tyre, të kryera nga shoqëria dhe prej filialeve të saj.

### **Neni 17 – Thirrjet dhe mbledhjet e Keshillit të Administrimit.**

Keshilli i Administrimit thirret nga Presidenti, edhe jashtë komunës, ku ndodhet selia e shoqërisë, për aq kohë sa është në Itali, kurdoherë që shfaqet nevoja me ane të një njoftimi me shkrim dërguar secilit prej keshilltareve dhe mbikqyresve në fuqi edhe me ane të faksit ose e-mailit, i cili duhet të marrë të paktën tre ditë para mbledhjes.

Në rast urgjence Keshilli mund të mbledhet dhe thirret edhe nepermjet telefonit, me një njoftim prej të paktën dymbëdhjetë orë përpara.

Presidenti ka detyrimin për të vazhduar me thirrjen në kohë të Keshillit të Administrimit, kur të beje një kërkesë me shkrim të paktën njëri nga Keshilltaret në detyrë ose Kryetari i Keshillit Mbikqyres.

**Rudina Mala (Djalipi)**  
Traduttore Giurato - Sworn Translator  
Tel: +355 672624 29  
E-mail: rudinalipi@shoqeria.com  
Ind./Adr.: Rr. "Duresit" n.37 Kati II  
Tirana - Albania



Thirrja duhet të përmbajnë te pakten informacion për datën, vendin dhe kohën në të cilën do të mbahet takimi si edhe rendin e ditës.

Keshilli i Administrimit quhet i mbledhur në mënyrë të vlefshme neqoftëse, edhe pa thirrjen formale, jane te pranishem të gjithë keshilltaret në detyrë dhe të gjithë mbikqyresit ne detyrë si dhe askush nuk e kundërshton diskutimin e temave.

Mbledhjet e Keshillit te Administrimit mund të mbahen dhe zhvillohen edhe nepermjet telekonferencës ose videokonferencës me kusht që të gjithë pjesëmarrësit te mund të identifikohen, t'u mundesohet atyre qe të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në kohë reale në diskutimin e temave si dhe te jenë informuar në mënyrë të barabartë; pasi te jene verifikuar keto kërkesa, Keshilli i Administrimit konsiderohet i mbajtur në vendin ku, eshte thirrur dhe zhvilluar.

Mbledhjet e Keshilli i Administrimit konsiderohen se janë mbledhur në mënyrë të vlefshme me kusht qe te ndërhyjnë të paktën shumicën e administratoreve dhe vendimet te miratohen me votimin pro (në favor) te shumices së të pranishmëve. Në çdo rast, këshilltarët që abstenojnë nga votimi për shkak të një interesi të tyre apo per llogari të palëve të treta, nuk do të numërohen në llogaritjen e kuorumit qe vendos si më sipër.

Keshilli i Administrimit - edhe here pas here - emëron sekretarin e Këshillit, duke zgjedhur edhe dike jashte anetareve perberes të tij.

## **Neni 18 – Kompetencat e organit administrativ**

Keshilli i Administrimit eshte i pajisur me kompetencat dhe fuqitë më të gjera për menaxhimin e shoqerise, pa përjashtim, me te drejten per të kryer të gjitha veprimet dhe aktet, edhe ato te disponimit, qe i konsideron te nevojshme për zbatimin dhe arritjen e qëllimeve objektive të shoqerise, duke përjashtuar vetëm ata se ligji ja rezervon ekskluzivisht Asamblese.

## **Neni 19 - Përfaqësimi i shoqerise**

Kryetarit te Keshillit te Administrimit dhe, në kufijtë e kompetencave te dhena, Keshilltareve te deleguar u takon, me nënshkrim te lire, përfaqësimi ligjor i shoqërisë perpara palëve të treta dhe në gjykatë, me te drejten per te nisur veprime dhe kerkesa gjyqesore dhe administrative në të gjitha nivelet e gjykimit si edhe të emërojnë sipas rastit avokatë dhe perfaqesues te posacem.

Anëtarët e Keshillit te Administrimit, edhe nëse nuk janë në posedim të një delegimi (emerimi) të përhershëm, kanë nënshkrimin e shoqerise dhe përfaqësojnë shoqërinë përpara të tretëve për zbatimin e vendimeve të miratuara nga Keshilli i Administrimit per të cilat duhet, te jenë të ngarkuar në mënyrë specifike.

Përfaqësimi i shoqerise për akte të vetme ose nje kategori të akteve, mund t'i caktohet punonjësve te shoqërisë si edhe të palëve të treta nga persona që kanë të drejtë për të ushtruar perfaqesimin ligjor.

**Rudina Mala (Dalipi)**  
Traduttore Giurato - Sworn Translator  
Tel: +355 67262429  
E-mail: rudidalipi@yahoo.com  
Ind./Adr.: Rr. "Durrësit" n.37 Kati II,  
Tirana - Albania

## **Neni 20 - Pagesat**

Anëtarë e Këshillit të Administrimit kanë të drejtë për kompensimin e shpenzimeve të kryera për shkak të funksionit të tyre. Tarifat e shpërblimeve që u takojnë administratoreve janë të përcaktuara nga asambleja.

Asambleja mund të përcaktojë gjithashtu shumën totale për shpërblimin e të gjithë administratoreve, duke përfshirë ato me përgjegjësi të veçanta; në këto rast Këshilli i Administrimit përcakton shpërndarjen e shpërblimit që duhet t'u paguhet administratoreve të cilët ushtrojnë përgjegjësi të veçanta, pas konsultimit me Këshillin e Mbikqyrjes.

Kur Asambleja nuk ka vepruar në përputhje me paragrafin e mësipërm, shpërblimi i administratoreve që ushtrojnë kompetenca të veçanta përcaktohet nga Këshilli i Administrimit pas konsultimit me Këshillin Mbikqyrës.

## **Këshilli Mbikqyrës dhe Auditit**

### **Neni 21 – Këshilli Mbikqyrës**

Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga tre (3) anëtarë në fuqi dhe 2 (dy) zëvendës të caktuar nga asambleja që emërohen gjithashtu edhe nga Presidenti.

Kërkesat, funksionet dhe përgjegjësitë e Këshillit Mbikqyrës janë të rregulluara me ligj.

Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës mund të mbahet me ane të tele/video-konferencës në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 17.

### **Neni 22 – Kontrolli ligjor**

Aktiviteti i kontrollit ligjor të shoqërisë i është besuar Këshillit Mbikqyrës, në përputhje me Ligjin duke u dhënë gjithësi aksionereve të drejtën për t'ja caktuar të njëjtën gjë një auditori të autorizuar ose një shoqërie auditimi në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

## **VITI USHTRIMOR - FITIMET**

### **Neni 23 - Viti ushtrimor**

Viti fiskal përfundon më 31 dhjetor të çdo viti. Asambleja për miratimin e bilancit duhet të mblidhet brenda njëqind e njëzet ditëve nga mbyllja e vitit ushtrimor ose brenda njëqind e tetëdhjetë ditëve në qoftë se plotësohen kushtet e parashikuar nga neni 2364, paragrafi i dytë, i Kodit Civil. Këshilli i Administrimit do të duhet të raportojë arsyet për vonesën në raportin për menaxhimin (drejtimin).

**Rudina Mala (Da'ipi)**  
Traduttore Giurato - Sworn Translator  
Tel: +355 672624 9  
E-mail: rudidalipi@...  
Ind./Adr.: Rr. "Duresis" 137K  
Tirana - Albania



## Neni 24 – Shperndarja e fitimeve

Fitimet neto qe rezultojne nga bilanci, i zbritur prej së paku 5% (pesë për qind) qe do të ndahet dhe destinohet për rezervën ligjore deri sa kjo të arrijë një të pestën e kapitalit aksionar do të shpërndahen në mesin e aksionarëve në proporcion me pjesën e tyre të kapitalit në pronësi të secilit, përveç se ne rastin kur asambleja nuk vendos për një destinacion të ndryshem dhe te ruaje (shpetoje) të drejtat e disa të kategorive të veçanta të aksioneve ose te instrumenteve financiare eventuale.

## SHKRIRJA DHE LIKUIDIMI

### Neni 25 - Shpërbërja dhe Likuidimi

Shpërbërja dhe likuidimi rregullohen me ligj.

## DISPOZITA TË FUNDIT

Për çështjet që nuk përkruhen ne statut merren per baze dispozitat e ligjit.

F.to Mario Granelli

F.to Fabrizio Rossi Noter

\*\*\*\*\*

Kopje konform originalit, qe leshohet ne leter te thjeshte per perdorimet per te cilat ligji nuk e parashikon pullen.

Castiglione delle Stiviere me 30.03.2016





**APOSTILLE**

*(Konventa e Hages e 5 tetorit 1961)*

1. Shteti, Itali
- Ky akt publik administrativ*
- 2 Eshte nenshkruar nga DR ROSSI FABRIZIO
3. Duke vepruar me cilesine e NOTERIT
4. eshte vendosur vula/ firma e ROSSI FABBRIZIO NOTER  
NE CASTIGLIONE DELLE STIVIERE


VERTETUAR

5. ne MANTOVA,
6. Me 05/04/2016
7. nga PROKURORI I REPUBLIKES
8. Me numer 203
9. vula
10. Nenshkrimi

Perktheu nga gjuha italiane ne gjuhen shqipe:

**Rudina Mala (Dalipi)**

Perkthyes e autorizuar nga Ministria e Drejtesise



**Rudina Mala (Dalipi)**  
Traduttore Giurato - Sworn Translator  
Tel: +355 672624029  
E-mail: rudidalipi@yahoo.com  
Ind./Adr.: Rr. "Duresit" n.37 Kati II,  
Tirana - Albania